



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINE**

---

Numri i lëndës: 2023:241907

Datë: 14.11.2023

Numri i dokumentit: 04914645

CPC.nr.1503/23

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, gjyqtari Ibrahim Maloku, në çështjen juridike përmbarimore të kreditores A.Q nga fshati ....., Komuna e Deçanit, kundër debitorës Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë, në çështjen juridike përmbarimore pagesën e borxhit, jashtë seancës gjyqësore, me datën 14.11.2023, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

I. Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, shpallet jo kompetente në pikëpamje gjyqësore, për të vendosur sipas propozimit për përmbarim të kreditorës A. Q, nën shenjën CPC.nr.1503/23, e dt.06.10.2023, kundër të debitorës Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë, në çështjen juridike pagesë e borxhit.

II. SHPALLEN TË PAVLEFSHME të gjitha veprimet procedurale të kryera nga ana e gjykatës në këtë çështje përmbarimore.

III. HEDHET POSHTË si e palejuar propozimi për përmbarim i kreditores A. Q, nën shenjën CPC.nr.1503/23, e dt.06.10.2023, kundër të debitorës Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë, në çështjen juridike për borxhë.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Kreditorja A. Q, pranë kësaj gjykate me datën 06.10.2023 ka ushtruar propozim për përmbarim kundër debitorës Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të Republikës së Kosovës, me seli në Prishtinë, lidhur me pagesën e borxhit.

Gjatë shqyrtimit paraprak të propozimit për përmbarim, në raport me provat të cilat ndodhën në shkresat e lëndës, kjo gjykatë ka ardhur në përfundim se të njëjtës i mungon kompetenca gjyqësore për të vendosur në këtë çështje juridike përmbarimore.

Kjo për faktin se me propozimin për përmbarim kërkohet pagesa e borxhit në emër të mbledhjeve të mbajtura nga kreditorja si Kryesuese e Komisionit për Shqyrtimin dhe Vlerësimin e Kërkesave dhe Projekteve Restauruese Konservuese të Trashëgimisë Kulturore, kërkesë kjo e cila rrjedh nga marrëdhënia e punës të cilën kreditorja e ka patur me debitorën.

Me dispozitën e nenit 3 të Ligjit nr.08/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr.05/L-118, është ndryshuar neni 5 paragrafi 6 i ligjit bazik, si në vijim “Neni 5 i ligjit bazik, paragrafi 6, nën-paragrafi 6.2, fjalët “dhe kompensimet tjera.”, fshihen. 2. Neni 5 i ligjit bazik, pas paragrafit 6 shtohet paragraf i ri 7, si vijon: 7. “Përmbaruesi privat është kompetent për të vendosur në procedurën e përmbarimit dhe zbatimin e përmbarimit të vendimeve gjyqësore, lidhur me kompensimet nga marrëdhënia e punës.”, nga rrjedh se nga data 25 gusht 2023 organ kompetent përmbarues për lejimin dhe zbatimin e përmbarimit në çështjen e pagave dhe kompensimeve të tjera është përmbaruesi privat.

Me dispozitën e nenit 17 të LPP-së, përcaktohet: “Në procedurën përmbarimore përshtatshmërisht zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën kontestimore, po qe se me këtë ligj ose me ndonjë ligj tjetër nuk parashihet diçka tjetër.”.

Kurse dispozita e nenit 18 par.1 e LPK-së, përcakton qartë se: “Gjykata, sipas detyrës zyrtare, gjatë gjithë procedurës kujdeset nëse zgjidhja e kontestit hynë ose jo në kompetencën gjyqësore.”. Në këtë mënyrë, Gjykata vlerëson se janë plotësuar prezumimet procedurale që të veprohet në kuptim të dispozitës së nenit 18 par.2 të LPK-së, e cila përcakton që “Kur gjykata gjatë procedimit të çështjes konstaton se për zgjidhjen e kontestit nuk është kompetente gjykata veçse ndonjë organ shtetëror tjetër, do të shpallet inkompetente, do t’i shpallë të pavlefshme të gjitha veprimet procedurale të kryera dhe do ta hedhë poshtë padinë që i është paraqitur”. Lidhur me këtë, dispozita e nenit 391 pika a) e LPK-së, përcakton: “Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po qe se konstaton se: a) çështja e ngritur me padi nuk hynë në kompetencën gjyqësore”.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës, si në pikën IV të dispozitivit të këtij aktvendimi, Gjykata e mbështeti në dispozitën nga neni 450 të LPK-së, e cila përcakton që: “Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta.”.

Mbi bazën e të lartëcekurave, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THMELORE NË PRISHTINË  
- Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil-  
CPC.nr.1503/23, dt.14.11.2023

Gjyqtari,  
Ibrahim Maloku

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa, në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.